



# KOSOVA\*

në rrugën e saj evropiane

#ZgjerimiI BE-së

## Pikat kryesore

### MARS 2011

Filloi dialogu Prishtinë-Beograd i ndërmjetësuar nga BE-ja

### PRILL 2013

Përfundoi "Marrëveshja e Brukselit" mes Beogradit dhe Prishtinës

### PRILL 2016

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

### MAJ 2016

Komisioni Evropian propozon udhëtimin pa viza për qytetarët e Kosovës

### TETOR 2016

Takimi i parë i Këshillit të Stabilizim Asociimit BE-Kosovë

### KORRIK 2018

Komisioni konfirmon se Kosova ka përbushur të gjitha standardet e pazgjdhura për liberalizimin e vizave



## Tregti dhe investime

- BE-ja është partneri më i madh tregtar i Kosovës
- Investimet e Huaja Direkte të BE-së në Kosovë arritën në 208 milionë euro në vitin 2021
- Vëllimi i tregtisë së mallrave me BE-në ishte 1.8 miliardë euro në 2021

Në 2021



## Financimi i BE-së

- BE-ja është ofruesi më i madh i financave ndihmë për Kosovën
- BE-ja po mbështet zhvillimin socio-ekonomik dhe reformat në rajonin e zgjerimit, duke përfshirë edhe Kosovën, me asistencë financiare dhe teknike përmes **Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA)**
- Për 2021-2027, financimi IPA III për të gjithë rajonin e zgjerimit është **14.162 miliardë euro\*\***. Ai u përgjigjet prioriteteve tematike




## Plani Ekonomik dhe i Investimit

Gjatë shtatë viteve të ardhshme, BE-ja do të mobilizojë deri në **30 miliardë euro** në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare. Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor filloi në vitin 2020. Projekti i mëposhtëm EIP për Kosovën u miratua në 2022:

- **Transport i qëndrueshëm:** Seksioni Prishtinë-Merdare i autostradës së Paqes që lidh Kosovën me Serbinë.

- Plani Vjetor i Veprimit 2021 për Kosovën parasheh një buxhet prej **63.96 milion €** në mbështetje të veprimeve në fushat e qeverisjes (qeverisja lokale), deminimi, mjedisi, zhvillimi ekonomik, bujqësia dhe zhvillimi rural
- Për vitet 2014 - 2020, financimi IPA II i ndarë për Kosovën ishte **573.1 milionë euro**
- 300 milionë euro të dhëna në kredi të Bankës Evropiane të Investimeve që nga viti 1999



● Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia

● Konkurrenshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse

● Qeverisja e mirë dhe marrëdhëniet fqinjësore

● Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar

● Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme

\*\* Asistencë e IPA-së bazohet në prioritetet tematike të BE-së dhe jo në alokimet e paracaktuara të vendeve, pra në shumën globale për rajonin e zgjerimit.



## Kapitali njerëzor dhe inovacioni

- BE-ja i kushton vëmendje rinisë, arsimit dhe inovacionit dhe po ndihmon Ballkanin Perëndimor të zbatojë skemat e Sigurisë Rinore për të mbështetur punësimin e të rinjve.
- 3,400+ pjesëmarrës nga Kosova në shkëmbime studentore, akademike dhe rinore nën programin ERASMUS+ (2014-2020).
- Janë dhënë 364 grante të 'Skemës së Qelizave të Reja' për studiues të administratës publike
- Mbi 4000 të rinj dhe të pafavorizuar morën trajnime për punësim dhe sipërmarrje
- 18.5 milion € në mbështetje të shoqërisë civile (2014-2020)

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës